

Dokument permbledhes i projektit

Titulli i projektit:	PROGRAMI I OSSH PER PERMIRESIMIN E EFICENCES TE SHPERNDARJES SE ENERGIJE ELEKTRIKE
Shteti:	Shqiperi
Numri i projektit:	41251
Spektori i biznesit:	Shperndarja e energjise elektrike
Publik/Privat:	Spektori privat
Data e shqyrtimit ne Bordin e Drejtoreve:	15 Mars 2011
Statusi:	Ka marre aprovimin perfundimtar
Data e botimit te PSD: Data e perditesimit te PSD:	11 Shkurt 2011
Pershkrimi i projektit dhe objektivat:	<p>Transaksioni i propozuar eshte nje kredi paresore afatgjate prej 50 milion EURO per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes ne Shqiperi ("CEZ Shperndarje", ose "Kompania") per te financuar programin e transformimit dhe te shpenzimeve kapitale te Kompanise me nje vlere rreth 200 milion EURO gjate viteve 2010-2014, qe synon uljen e humbjeve ne sistemin e shperndarjes, permiresimin dhe modernizimin e rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike si edhe permiresimin e gjendjes financiare dhe operacionale te Kompanise ("Projekti"). CEZ Shperndarje zoterohet ne masen 76 per qind nga grupi energjetik çek ĀEZ a.s. i cili luan rolin e Sponsorit (Mbeshtetesit) ne kete transaksion.</p> <p>Plani i investimit te Kompanise per vitet 2010-2014 arrin ne rreth 200 milion EURO dhe perfshin masat e meposhtme: (i) modernizimin e rrjetit te shperndarjes qe mbulon linjat me tension te ulet (50 milion EURO) dhe linjat me tension te mesem (44 milion Euro); (ii) rehabilitimin e nenstacioneve (54 milion EURO); (iii) instalimin e matesve te rinj (49 milion EURO); dhe (iv) venien ne zbatim te nje sistemi te ri faturimi, SAP (3 milion EURO)</p> <p>Ky program investimi parashikohet te sjelle nje permiresim thelbesor te gjendjes operacionale te Kompanise, zvogelim te humbjeve ne sistemin e shperndarjes nen nivelin aktual prej 34% dhe vendosjen e matesve qe do te ndihmojne ne forcimin e disjplines se pageses dhe per rrjedhoje do te beje te mundur qe CEZ Shperndarje te permiresoje nivelin e arketimit mbi ate aktual prej 82 per qind.</p>
Ndikimi ne tranzicion:	<p>Ndikimi ne tranzicion i Projektit buron nga dy faktore: (i) efekti demonstrativ i nje transformimi te suksesshem ku BERZH do te mbeshtete ĀEZ a.s. si nje Sponsor me pervoje dhe me nje karriere te suksesshme si operator i rrjeteve te shperndarjes se energjise elektrike ne Bullgari dhe Rumani; dhe (ii) vendosja e standarteve per drejtimin e biznesit-zvogelimin e humbjeve.</p>
Klienti:	CEZ Shperndarje eshte e vetmja kompani e shperndarjes dhe shitjes me pakice te energjise elektrike ne Shqiperi. Kompania

	zoteron dhe operon te gjithe rrjetin 110kV te shperndarjes ne vend, qe perfshin 69,000 km dhe aktualisht u sherben rreth 1.1 milion konsumatoreve. Energjia elektrike totale e furnizuar ne 2009 ishte 4.1 TWh. CEZ Shperndarje u krijua nga ndarja prej nje kompanie sherbimi te integruar ne 2008 dhe u privatizua ne Maj 2009, me perfundimin e shitjes se 76 per qind te aksioneve kompanise ČEZ a.s.
Financimi i BERZH:	BERZH po shqyrton dhenien e nje kredie paresore korporative prej 50 milion EURO per te financuar nje pjese te programit prej 200 milione EURO te transformimit dhe permiresimit te efences se CEZ Shperndarjes ne vitet 2010-2014. IFC, financues te tjere komerciale dhe CEZ Shperndarje ne bashkepunim me ČEZ priten te japin pjesen e mbetur te financimit.
Kostoja totale e projektit:	200 milion EURO

Klasifikimi mjedisor dhe arsyet

Projekti eshte i kategorise B. Programi i propozuar per investimet kapitale perfshin kryesisht investime ne modernizimin e rrjetit dhe nenstacioneve, sistemin e ri te matesave dhe faturimit. Informacioni aktual i vene ne dispozicion nuk eshte i mjaftueshem per kryerjen e nje analize mjedisore dhe sociale per programin e investimeve kapitale, megjithate nuk do te perfshije ndonje linje te tensionit te larte dhe, per rrjedhoje zbatimimi i programit ka gjasa te kete ndikime te vogla negative mjedisore dhe shoqerore, te cilat mund te shmangen apo te lehtesohen nepermjet zbatimit te standarteve, udhezimeve apo kritereve te projektimit qe njihen gjeresisht.

Analiza e kryer (*due diligence*) dhe perfundimet

Analiza e kryer per projektin perfshin sa me poshte:

- Rishikimin e raportit mbi Kushtet Mjedisore Baze te Rrjeteve te Shperndarjes te pergatitur per Ilogari te IFC ne vitin 2008;
- Rishikimin e menaxhimit te Kompanise; dhe
- Auditimin mjedisor dhe social te aktiviteve dhe objekteve te Kompanise, per te vleresuar Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social- (**SMMS**) te tij dhe performancen e meparshme/tanishme perkundrejt Raporteve te Progresit (RP) perkates.

Kategorizimi mjedisor dhe social, ndikimi dhe masat lehtesuese:

Problemet kryesore te identifikuar gjate analizes (*due diligence*) lidhen me mungesen e sistemeve te percaktuara te menaxhimit te mjedisit, shendetit dhe sigurise (MSHS); ndotjes se dherave dhe ujrave nentokesore; politikave dhe procedurave te burimeve njerezore; punes dhe kushteve te punes; menaxhimit dhe shkurtimeve te planifikuara te personelit; incidentet ndaj paleve te treta; dhe angazhimet e paleve te interesuara.

Permbledhje e Planit te Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS)

Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS) eshte aktualisht duke u pergatitur per te trajtuar problemet e identifikuar gjate analizes dhe po diskutohet ndermjet BERZH dhe IFC. Detyrat paresore ne PVMS kane te bejne me sa me poshte:

- Pergatitjen e nje Politike MSHS brenda CEZ Shperndarjes dhe ngritjen e Sistemeve te Menaxhimit MSHS brenda CEZ Shperndarjes;

- Pergatitjen e procedurave te MSHS dhe burimeve njerezore si dhe te udhezimeve teknike dhe njohjen e tyre nga punonjesit;
- Vleresimin Mjedisor dhe Social te perberesve te programit te investimit pasi percaktimit te tyre;
- Regjistrimin e mangesive te masave te sigurise (p.sh. puseta te hapura, mbrojtja ndaj zjarrit, rrethimet) dhe zbatimimi i masave te pershtatshme per menjanimin e tyre.
- Regjistrimin e ndotjes me PCB te vajrave, dherave dhe ujrave nentokesore si dhe hartimi i nje programi menaxhimi;
- Ngritjen e nje programi monitorimi per dherat dhe ujrata nentokesore;
- Regjistrimin e materialeve me permbajtje asbesti dhe menaxhimin e ketyre materialeve;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve te trainimit; dhe
- Hartimin dhe zbatimin e nje plani per shkurtime te personelit; dhe hartimin dhe zbatimin e nje plani per angazhimin e grupeve te interesit.

Monitorimi dhe raportimi

Kompania do te:

- dorezoje prane Bankes Raportin Vjetor Mjedisor dhe Social (RVMS), duke perfshire dhe perditesimet e PVMS dhe njoftimet e ndonje aksidenti apo incidenti material;
- mundesoje vizita periodike monitorimi te personelit te Bankes apo te perfaqesuesve te emeruar sa here qe te shihet e nevojshme.

Bashkepunim teknik:

Asnje.

Mundesi prokurimi ose tenderimi:

Vizitoni [EBRD Procurement](#)
Kerkesat: Tel: +44 20 7338 6794; Fax: +44 20 7338 7472
Email: procurement@ebrd.com

Kerkesa te pergjithshme:

Pyetje per projekte te BERZH qe nuk lidhen me prokurime:
Tel: +44 20 7338 7168; Faks: +44 20 7338 7380
Email: projectenquiries@ebrd.com

Politikat e Informimit Publik (PIP)

PIP percakton se si BERZH jep informacion dhe keshillohet me grupet e interesit se si te promovojte rritjen e ndergjegjesimit dhe mirekuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteteve te saj.

[Teksti i PIP](#) mund te gjendet ne:

<http://www.ebrd.com/pages/about/what/policies/pip.shtml>

Mekanizmi i pavarur i ankimimeve

BERZH ka ngritur MPA per t'u dhene grupimeve vendore qe

(MPA)	<p>mund te ndikohen ne menyre direkte dhe negativisht nga nje projekt i Bankes, nje mundesi per te shprehur nje pakenaqesi ose per te bere nje ankimim ne Banke, ne menyre te pavarur nga veprimtarite bankare.</p> <p>Udhezuesit per kryerjen e nje ankimimi dhe Rregullat e Proceduriale mund te gjenden ne:</p> <p>http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/index.htm</p>
-------	---